

Në Hagë, më 24 prill 2023

**Për:** Znj. Argjira Asllani

Njësia për Koordinimin e Procesit Mbrojtjen  
Juridike dhe Mbështetjen Financiare të  
Personave të Akuzuar Potencial në Proceset  
Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara  
Ministria e Drejtësisë  
Republika e Kosovës

**Cc:** Komisioni për Shqyrtimin dhe  
Vendosjen e Kërkesave

**Tema:** *Kërkesë për rritjen e tarifave për shërbimet dhe shpenzimet sipas Udhëzimit  
Administrativ Nr. 08/2022*

E nderuar znj. Asllani,

Në emër të katër të akuzuarve në rastin *Hashim Thaçi et al.* pranë Dhomave të Specializuara, përkatësisht z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi (*referuar më tej si "katër të akuzuarit"*), po ju dorëzojmë kërkesën tonë për rritjen e tarifave të avokatëve dhe shpenzimeve të tjera në përputhje me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 08/2022 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara (*referuar më tej si "Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022"*).

Kjo kërkesë pason plotësim-ndryshimin e fundit të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022, i cili parashihet tarifa të reja për avokatët dhe shpenzimet e tjera për mbrojtjen juridike të të akuzuarve në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. Katër të akuzuarit shprehin shqetësimin e tyre se tavanet në tarifave të avokatëve dhe shpenzimet e tjera të prezantuara rishtazi në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 nuk reflektojnë kostot aktuale që mbrojtja pëson në këto raste. Për rrjedhojë, mundësia që katër të akuzuarit të realizojnë një mbrojtje efikase dhe efektive është në rrezik. Me udhëzime bashkërisht nga katër të akuzuarit, po ju paraqesim një kërkesë për rritjen e tarifave të avokatëve dhe shpenzimet e tjera për kompensim për arsyet si në vijim.

Që në fillim, duam të shprehim shqetësimet tona sa i përket mënyrës dhe metodës së kalkulimit të shumave ligjore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022. Ndonëse e respektojmë obligimin e organeve publike si Ministria e Drejtësisë për t'u kujdesur për fondet publike, theksojmë gjithashtu se Ministria duhet të kujdeset për fondet publike në një mënyrë që nuk rrezikon mbrojtjen e katër të akuzuarve në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

Ne kemi vënë re se Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 paraqet një sërë anomalish në lidhje me tarifave për mbrojtjen juridike dhe shpenzimet e tjera të cilat jo vetëm se nuk pasqyrojnë kostot ekonomike për mbrojtjen e rasteve të madhësisë dhe rëndësisë së tillë, por mbi të

gjitha nuk përputhen me disa nga dispozitat e tjera të Udhëzimit Administrativ apo me praktikat e vendeve të tjera të rajonit.

Për shembull, Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 prezanton një skemë të re kompensimi ku shuma përcaktohet nga një sërë faktorësh të listuar në aktin nën-ligjor. Së pari, shuma për kompensim varet nga faza e procedurave. Faktori vendimtar në përcaktimin e shumës për kompensim ndërlidhet me kompleksitetin e rastit, duke filluar me kompleksitetin “*të lehtë*” për ato të cilësuar si kompleksiteti 1, e deri tek “*shumë e vështirë*” për rastet e kompleksitetit 4.<sup>1</sup> Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022, Komisioni merr parasysh një sërë faktorësh kur përcakton kompleksitetin e një rasti, duke përfshirë këtu por pa u limituar në pozitën e pretenduar e të akuzuarit në hierarkinë politike ose ushtarake; numrin dhe natyrën e akuzave në aktakuzë; numrin dhe llojin e dëshmitarëve dhe dokumenteve të çështjes; shtrirjen gjeografike të krimeve të pretenduara në aktakuzë; nëse çështja ngre aspekte të reja apo kompleksitetin e argumenteve ligjore dhe faktike të çështjes.<sup>2</sup> Pra, sa më kompleks të jetë rasti, aq më shumë burime njerëzore dhe materiale nevojiten për të siguruar një mbrojtje adekuate dhe profesionale. Për sa më sipër, Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 parasheh se për një rast të kompleksitetit 4 (pra, rasti më i vështirë), ekipi mbrojtës i të akuzuarit duhet të ketë të paktën 12 anëtarë.<sup>3</sup>

Siç jeni në dijeni, rasti *Hashim Thaçi et al.* ka hyrë tashmë në fazën e gjykimit. Është krejtësisht e qartë se rasti në fjalë përmbush të gjitha kriteret e listuara për “Kompleksitetin 4” sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022. Në fakt, mjafton që të shikoni numrin e dëshmitarëve që Prokuroria synon të thërrasë për të përcaktuar kompleksitetin dhe madhësinë e rastit. Aktualisht, lista e dëshmitarëve të Prokurorisë përfshin 312 dëshmitarë, numër ky që ndjeshëm kalon numrin e dëshmitarëve që Prokuria kishte thirrur në raste të ngjashme pranë Tribunalit Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (“**TNPJ**”).

Për më tepër, aktakuza e ndryshuar shtrihet për një periudhë prej 1 viti e gjysëm dhe ngarkon të katër akuzuarit me shtatë vepra për krime kundër njerëzimit dhe katër vepra për krime lufte.<sup>4</sup> Konflikti daton mbi 2 dekada më herët, me pjesën dërrmuese të konfliktit të gjykuar apo shqyrtuar nga një sërë procedurash pranë gjykatave vendore, apo institucioneve të tjera ndërkombëtare si EULEX-I, UNMIK-u, dhe TNPJ-a. Për rrjedhojë, të katër ekipet tona të mbrojtjes duhet të angazhojnë orë të panumërta pune për të shqyrtuar materialet nga secili nga këto juridiksione, përfshirë këtu edhe shqyrtimin e dëshmive të dëshmitarëve dhe dokumentave nga të gjitha këto procese. Kjo është një barrë shtesë mbi atë bazë – shqyrtimin e sasive të mëdha dëshmish të reja dhe dokumentave të mbledhura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Pra, përgatitja e mbrojtjes juridike kërkon një dedikim të madh burimesh nga të katër ekipet e mbrojtjes, e gjitha kjo ndërkohë që gjykimi është në rrjedhë e sipër dhe mbrojtja është duke marrë në pyetje dëshmitarë në seancë gjatë gjithë ditës.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022, forma e kompensimit të tarifave të avokatëve përcaktohet “*në bazë të praktikave të vendeve të shteteve nga vijnë avokatët dhe tarifave të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ të Dhomave të Specializuara.*”<sup>5</sup> Vlen të theksohet

---

<sup>1</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022, Shtojca 1, f. 21

<sup>2</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 21

<sup>3</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 22 (një avokat, dy bashkëmbrojtës, pesë ndihmës juridikë dhe katër ndihmës administrativë)

<sup>4</sup> Akuza e ndryshuar e Zyrës së Prokurorit të Specializuar në rastin KSC-06-2020 – Hashim Thaçi et al., Shkurt 23, 2023, e qasshme në: [https://repository.scp-ks.org/details.php?doc\\_id=091ec6e980e32167&doc\\_type=stl\\_filing\\_Shtojca&lang=eng](https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e980e32167&doc_type=stl_filing_Shtojca&lang=eng)

<sup>5</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 20

se shumica e avokatëve të angazhuar në ekipet mbrojtëse të katër të akuzuarve vijnë nga juridiksione ku tarifat për orë janë ndjeshëm më të larta se tarifat e paraqitura në tabelën e Shtojcës 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022. Pra, përkundër asaj se çfarë thuhet në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 si më sipër, tarifa për orë e propozuar nuk përputhet me “*praktikat e vendeve të shteteve nga vijnë avokatët.*”

Për më tepër, praktika e vendeve të rajonit për raste të ngjashme gjithashtu dallon ndjeshëm me tarifat e ofruara në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022. Për shembull, Qeveria e Kroacisë fqinje gjithashtu kishte mbuluar shpenzimet për mbrojtjen juridike të shtetasve të saj të akuzuara pranë TNPJ-së. Kroacia ka paguar mbi 28 milion Euro nga buxheti i saj publik për të mbuluar shpenzimet për mbrojtjen juridike në një nga këto raste.<sup>6</sup> Megjithatë, rasti në fjalë përfshinte **tre** të akuzuar nga **katër** që janë këtu, dhe Prokuroria atje kishte thirrur vetëm **81** dëshmitarë,<sup>7</sup> apo një e katërta e dëshmitarëve në rastin konkret.

Përveç çështjeve të identifikuara më lart, sistemi i pagesave “*duhet të ofrojë mekanizma mjaft fleksibil për t’u përshtatur situatave kur ato lindin në mënyrë që të parandalojnë interesat e administrimit të duhur të drejtësisë*”<sup>8</sup> Mirëpo në praktikë, ky sistem i pagesave nuk rezulton të jetë mjaftueshëm fleksibël për të siguruar administrin e duhur të drejtësisë për katër të akuzuarit.

Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022 liston një sërë tabelash që shpjegojnë kalkulimet përkatëse për mënyrën e pagesës së tarifave të avokatëve dhe shpenzimeve të tjera. Megjithatë, kalkulimet e prezantuara në këto tabela përfshijnë disa gabime të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në skemën e kompensimit dhe rrezikojnë mbrojtjen e katër të akuzuarve. Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ prezanton një tarifë për orë për secilin anëtar të ekipit mbrojtës, varësisht nga roli i tij/saj.<sup>9</sup>

Për rastet e kompleksitetit 4, Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 parasheh këto tarifa për orë:

Avokati Mbrojtës	Bashkëmbrojtësi	Ndihmësi Juridik	Ndihmësi Administrativ
400 euro	180 euro	140 euro	120 euro

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 gjithashtu parasheh se një ekip mbrojtës për një rast të kompleksitetit 4 përbëhet nga **një** avokat mbrojtës, **dy** bashkëmbrojtës, **pesë** ndihmës juridikë dhe **katër** ndihmës administrativë.<sup>10</sup>

Megjithatë, kalkulimet në tabelën e Shtojcës 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022 nuk reflektojnë këtë përbërje të ekipit.<sup>11</sup> Më konkretisht, tabela në Shtojcën 1 paraqet tarifat mujore për mbrojtjen juridike dhe shpenzimet e tjera për një ekip mbrojtës (120 orë për muaj) duke llogaritur vetëm nga **një** anëtar për secilën kategori/rol, si në vijim:

<sup>6</sup> Balkan Insight, “How ex-Yugoslav States funded war crimes defendants,” December 23, 2013, e qasshme në <https://balkaninsight.com/2013/12/23/how-ex-yugoslav-states-funded-war-crimes-defendants/>

<sup>7</sup> *Shih* Prokuroria v. Ante Gotovina, Ivan Cermak & Mladen Markac, IT-06-90, e qasshme në: [https://www.icty.org/x/cases/gotovina/cis/en/cis\\_gotovina\\_al\\_en.pdf](https://www.icty.org/x/cases/gotovina/cis/en/cis_gotovina_al_en.pdf)

<sup>8</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022, Shtojca 1, f. 20

<sup>9</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 22-23

<sup>10</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 22

<sup>11</sup> *Ibid.*, Shtojca 1, f. 23

Kompleksiteti 4					
Avokati Mbrojtës	Bashkëmbrojtësi	Ndihmësi Juridik	Ndihmësi Administrativ	Shpenzime të tjera	TOTAL
400x120= 48,000.00	180x120= 21,600.00	140x120= 16,800.00	120x120= 14,400.00	9,200.00	110,000.00

Pra, edhe pse Udhëzimi Administrativ përcakton se për një rast të kompleksitetit 4 ekipit mbrojtës i takojnë së paku 12 anëtar në ekip, Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ kompenson për vetëm katër nga dymbëdhjetë anëtarët e paraparë të ekipit mbrojtës. Ky është qartazi një gabim që shkakton një dëm të madh për katër të akuzuarit. Theksojmë këtu se secili nga katër ekipet mbrojtëse në rastin *Hashim Thaçi et al.* përbëhet nga një numër dukshëm më i madh i anëtarëve se ekipi katër anëtarësh i supozuar në Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022 dhe secili anëtar i ekipit punon ndjeshëm më shumë se 120 orë për muaj.

Rrjedhimisht, tabela e mësipërme nuk pasqyron shpenzimet e nevojshme për një ekip për një rast të kompleksitetit 4. Tabela e mësipërme (nga Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022) nuk përfshin në kalkulimin total të tarifave kostot e bashkëmbrojtësit të dytë, katër ndihmësve të tjerë juridikë dhe tre ndihmësit e tjerë administrativë. Sipas përbërjes së ekipit siç është caktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022,<sup>12</sup> shumat/vlerat në tabelën e mësipërme për bashkëmbrojtësin, ndihmësin juridik dhe ndihmësin administrativ duhen shumëzuar secila respektivisht me 2, 5 dhe 4, duke e sjellë shumën totale për kompensim në **242,000.00 Euro për muaj për ekip.**

Një ndër qëllimet e Udhëzimit Administrativ është që të ruaj një ekuilibër midis burimeve dhe mjeteve të akuzuarit dhe atyre të Prokurorisë.<sup>13</sup> Në emër të katër të akuzuarve, ju sigurojmë se kompensimi për një ekip mbrojtës me maksimum katër anëtarë as nuk i afrohet burimeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në rastin konkret. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022 thekson se synon që të arrijë një “barazi të palëve”, çka nënkupton se sistemi i pagesave duhet t’i mundësojë katër të akuzuarve të prezantojnë rastin e tyre pranë Dhomave të Specializuara nën kushte që nuk i vendosin ata në një disavantazh të theksuar *vis-à-vis* Prokurorisë. Siç u shpjegua më sipër, kalkulimet aktuale të paraqitura në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 mbulojnë shpenzimet për tarifën e vetëm 1/3 të ekipit mbrojtës (pra, katër anëtarë nga dymbëdhjetë), çka siguroshet i vë ekipet mbrojtëse në rastin *Hashim Thaçi et al.* në një disavantazh thelbësor në krahasim me burimet në dispozicion për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ne jemi gjithashtu të shqetësuar me mënyrën e kalkulimit për kompensimin e ‘shpenzimeve të tjera’. Si në rastin e tarifave të avokatëve, shumat e parapara në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 nuk pasqyrojnë realitetin ekonomik në këto raste. ‘Shpenzime të tjera’ është një kategori e përgjithshme e paraparë të mbulojë gjerësisht një numër shpenzimesh nga ato për përkthime tëk mjetet e zyrës, si dhe kostot e udhëtimit, tarifën e ekspertëve, etj. Në një projekt të një madhësie të tillë siç është rasti këtu, nuk duhet të jetë e habitshme që këto shpenzime sigurisht tejkalojnë 9,200.00 Euro për muaj.

<sup>12</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022, Shtojca 1, f. 22 (Niveli i kompleksitetit 4 – faza e procedurës paraprake, faza e gjykimit, faza e apelit: **një** avokat, **dy** bashkëmbrojtës, **pëse** ndihmës juridikë dhe **katër** ndihmës administrativë të ekipit, si dhe shpenzimet e tjera) (**theks i shtuar**)

<sup>13</sup> *Ibid*, f. 20

Ne e kemi të vështirë të kuptojmë analizën që është ndërmarrë për të përcaktuar tavanin prej 9,200.00 Euro për muaj për ‘shpenzime të tjera’ në rastet e kompleksitetit 4. Tabela në Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022 parasheh se në një rast të kompleksitetit 3 (pra, një rast më pak kompleks dhe më i vogël sesa një rast i kompleksitetit 4), ekipi mund të kërkojë 9,600.00 Euro kompensim për ‘shpenzime të tjera’, ndërsa një ekip në një rast të kompleksitetit 4 mund të kërkojë vetëm 9,200.00 Euro për muaj.<sup>14</sup> Shpenzimet në raste më komplekse sigurisht se janë më të larta se ato më pak komplekse. Ndaj, kompensimi nga ana e Republikës së Kosovës për këto shpenzime duhet të jetë dukshëm më i lartë.

Republika e Kosovës ka miratuar një ligj që garanton mbrojtje juridike adekuate dhe mbulon shpenzime për tarifat e avokatëve dhe shpenzimet e tjera për personat e akuzuar në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. Madhësia dhe kohëzgjatja e këtij rasti së bashku me akuzat e ngritura kundër katër të akuzuarve si dhe numri i theksuar i dëshmitarëve dhe viktimave që do të dëshmojnë në këtë rast e bëjnë të qartë se mbrojtja e katër të akuzuarve është një ndërmarrje me një fushëveprim të paprecedentë. Kjo do të kërkojë orë pune dhe burime shumë herë më të larta se ato që parashihen aktualisht në sistemin e pagesave. Në emër të katër të akuzuarve, me respekt kërkojmë një rritje në tarifat e avokatëve dhe shpenzimeve të tjera në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 në një nivel që pasqyron realitetin ekonomik të këtij rasti dhe siguron një përfaqësim dinjitoz dhe profesional të katër akuzuarve pranë Dhomave të Specializuara.

Për fund, ndonëse orët mujore që ekipet tona punojnë tejkalojnë dukshëm orët mujore që mund të kompensohen sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2022, dhe ndonëse tarifat për orë të caktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022 janë më të ulëta se tarifa standarte për orë në juridiksionet përkatëse të avokatë mbrojtës, ekipet mbrojtëse të katër të akuzuarve propozojnë vetëm që për secilin ekip mbrojtës të nderohet alokimi i parapara për ekip siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022, pra, tarifat e caktuara për orë të paguhet për të **gjithë 12 anëtarët e ekipit** siç parashihet nga Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022. Pra, në rastin konkret, duke marrë parasysh se rasti *Hashim Thaçi et al.* është kategorizuar si rast i kompleksitetit 4, me mirësjellje ftojme Komisionin që të rishqyrtojë tarifat e avokatëve, ashtu që tarifat e të gjithë 12 anëtarëve të ekipit të mbulohen, siç edhe parashihet në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022<sup>15</sup> dhe për rrjedhojë të rritet shuma totale për tarifat e avokatëve për muaj në **EUR 242,000 për muaj**. Ngjashëm, do ju ishim mirënjohës nëse kategoria e ‘shpenzimeve të tjera’ rishqyrtohet gjithashtu, ashtu që një rast i kompleksitetit 4 nuk i alokohet një kompensim më i ulët për shpenzime se një rast i kompleksitetit 3 dhe përfundimisht ashtu që kostot e kompensueshme korrespondojnë me realitetin ekonomik për rastet e këtij kompleksiteti.

Ju faleminderit për shqyrimin e kësaj kërkesë. Mbesim në pritje të një përgjigje nga ju.

Me respekt,

---

<sup>14</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2022, Shtojca 1, f. 23-24 (*Shih* ‘Shpenzimet e tjera’ në kompleksitetin 3 në shumën 9,600.00 Euro, ndërsa në kompleksitetit 4 në shumën 9,200.00 Euro)

<sup>15</sup> Si u shpjegua më lart, duke u bazuar në tarifat prej 120 orësh për muaj dhe në tarifat për orë si të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2022, shuma totale për kompensim për tarifat e avokatëve për ekip për një rast të kompleksitetit 4 janë 242,000.00 Euro për muaj



Luka S. Mišetić

Avokat për Hashim Thaçin



Ben Emmerson

Avokat për Kadri Veselin



David Young

Avokat për Rexhep Selimin

Data: 24 / 4 /2023



Alegendra Venkateswari

Avokat për Jakup Krasniqin